



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-062
Prishtinë, më 28 dhe 29 prill 2016

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 28 DHE MË 29 PRILL 2016**

Seancën e drejtoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmuan Xhavit HALITI dhe Sabri HAMITI, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryetari, para se të procedojë me rendin e ditës, i njoftoi deputetët me vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për zëvendësimin e një deputeti në Kuvendin e Republikës së Kosovës, zonja Mirjeta Kalludra, kandidate e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, e zëvendëson zonjën Teuta Sahatqija, deri më tani deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e ftoi deputeten Mirjeta Kalludra që ta japë betimin. Ai e lexoi tekstin e betimit, ndërsa në fund deputetja e shqiptoi fjalën “Beto hem!” dhe e nënshkroi tekstin e betimit.

Pastaj, kryetari procedoi me propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

1. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetja Njomza Emini emërohet kryetare e Komisionit për Integritet Evropian, në vend të ish-deputetes Teuta Sahaqija.
2. Deputeti Hatim Baxhaku emërohet zëvendëskryetar i parë i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në vend të deputetes Njomza Emini.
3. Deputetja Mirjeta Kalludra emërohet anëtare e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në vend të deputetes Njomza Emini.

Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, kërkoi që bëhet riradhitje e pikave të rendit të ditës, përkatësisht në fillim të procedohet me zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së.

Kuvendi, me shumë votash, e miratoi propozimin e lartshënuar.

Pastaj, Kuvendi i zhvilloi punimet sipas pikave në vijim:

2. Zgjedhja e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Komisionit ad hoc për ta paraqitur raportin e komisionit me rekomandime.

Deputetja Selvi Halimi, në emër të Komisionit ad hoc, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit me rekomandime.

Kryetari i ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i propozojnë anëtarët e Komisionit votues me përbërje nga një deputet prej secilit grup parlamentar, në mbështetje të zyrtarëve të Administratës.

Kuvendi, me propozimin e grupeve parlamentare, e formoi Komisionin votues në këtë përbërje:

1. Xhevaire Izmaqi, nga GP i PDK-së,
2. Salih Morina, nga GP i PDK-së,
3. Bojan Mitiq, nga GP i LS, dhe
4. Mufera Shiniqi, nga GP "6+".

Pastaj, kryetari i ftoi deputetët një nga një për të votuar për kandidatët e propozuar nga Komisioni ad hoc.

Pas procedurave të votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues, raportin e rezultateve të votimit e paraqiti deputetja Xhevaire Izmaqi. Ajo deklaroi se në votim kanë marrë pjesë 79 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 21 fletëvotime. Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

1. Elif Tokmak i ka fituar 49 vota dhe
2. Agim Rifat i ka fituar 9 vota.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me votim të fshehtë, mori këtë:

V E N D I M

Znj. Elif Tokmak zgjidhet anëtare e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komuniteteve tjera joshumicë, me mandat tre (3) vjeçar.

3. Zgjedhja e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Komisionit ad hoc për ta paraqitur raportin e komisionit me rekomandime.

Deputetja Xhevaire Izmaku, në emër të Komisionit ad hoc, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit me rekomandime.

Kuvendi, me propozim të kryetarit, vendosi që Komisionit votues, i formuar më parë, të vazhdojë me procedurat e votimit edhe për pikat tjera për zgjedhjen e anëtarëve në bordet e organeve të tjera që ishin në rend dite të seancës së sotme.

Pastaj, kryetari i ftoi deputetët një nga një për të votuar për kandidatët e propozuar nga Komisioni ad hoc.

Pas procedurave të votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues, raportin e rezultateve të votimit e paraqiti deputetja Xhevaire Izmaku. Ajo deklaroi se në votim kanë marrë pjesë 81 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 4 fletëvotime. Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

1. Abit Hoxha i ka fituar 47 vota,
2. Anita Morina-Saraçi i ka fituar 42 vota,
3. Diar Xani i ka fituar 41 vota dhe
4. Venera Buçaj i ka fituar 13 vota.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votim të fshehtë, mori këtë:

V E N D I M

Z. Abit Hoxha dhe znj. Anita Morina-Saraçi zgjidhen anëtarë të Komisionit të Pavarur për Medie nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, me mandat dy (2) vjeçar.

4. Zgjedhja e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor që ta paraqesë raportin dhe rekomandimin e komisionit.

Kryetarja e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, znj. Duda Balje, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit nga dy kandidatë të propozuar për secilën pozitë.

Pastaj, kryetari i ftoi deputetët një nga një për të votuar për kandidatët e propozuar nga Komisioni ad hoc.

Pas procedurave të votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues, raportin e rezultateve të votimit e paraqiti deputetja Xhevaire Izmaqi. Ajo deklaroi se në votim për pozitën e drejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit kanë marrë pjesë 84 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 4 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për drejtor të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit janë, si në vijim:

1. Nazmi Jashari i ka fituar 28 vota dhe
2. Raif Preteni i ka fituar 52 vota.

Ndërsa, për kandidatët e propozuar për zëvendësdrejtor të Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit kanë votuar gjithsej 84 deputetë, 16 fletëvotime janë të pavlefshme.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për zëvendësdrejtor të Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të ujit janë, si në vijim:

1. Bogoljub Staletoviq i ka fituar 31 vota dhe
2. Halil Bllaca i ka fituar 37 vota.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me votim të fshehtë, mori këtë:

V E N D I M

1. Z. Raif Preteni zgjidhet drejtor i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, me mandat pesë (5) vjeçar.
2. Kandidatët e propozuar, z. Bogoljub Staletoviq dhe z. Halil Bllaca, asnjëri nuk i mori votat e nevojshme për t'u zgjedhur zëvendësdrejtor i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit.

5. Zgjedhja e një anëtarit në Këshillin Prokurorial të Kosovës

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Komisionit FunkSIONAL për ta paraqitur raportin e komisionit me rekomandime.

Deputetja Selviqe Halimi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime të komisionit për pozitën e anëtarit nga fakultetet juridike, që ishin propozuar Rexhep Gashi, Azem Hajdari dhe Xhevdet Halili. Ndërsa Kuvendi duhet ta zgjedhë njërin prej tyre për anëtar të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Pastaj, kryetari i ftoi deputetët një nga një për të votuar për kandidatët e propozuar nga Komisioni ad hoc.

Pas procedurave të votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues, raportin e rezultateve të votimit e paraqiti deputeti Salih Morina. Ai deklaroi se në votim kanë marrë pjesë 44 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 9 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

1. Rexhep Gashi i ka fituar 26 vota,
2. Azem Hajdari s'e ka fituar asnjë votë dhe
3. Xhevdet Halili i ka fituar 39 vota.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me votim të fshehtë, mori këtë:

V E N D I M

Kandidatët e propozuar: Rexhep Gashi, Azem Hajdari dhe Xhevdet Halil asnjëri nuk i mori votat e nevojshme për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit Prokurial të Kosovës nga fakultetet juridike.

6. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor që ta paraqesë raportin e komisionit me rekomandime.

Kryetarja e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, znj. Duda Balje, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime lidhur me propozim-vendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit.

Komisioni Parlamentar për Bujqësi e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Për mungesë të kuorumit, kryetari nuk procedoi me votimin e kësaj pike.

7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisioni Funkcional që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e komisionit me rekomandime.

Nënkryetari i Komisioni për Integritet Evropian, z. Slobodan Petroviq, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin dhe 13 rekomandime të komisionit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Pastaj, kryesuesi e hapi diskutimin lidhur raportin e lartshënuar.

Për raportin e Komisionit Funkcional për zbatimin e Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale diskutuan deputetët: Luljeta Veselaj-Gutaj, në emër të GP të PDK-së; Slavko Simiq, në emër të GP LS, si dhe Gëzim Kelmendi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Për mungesë të kuorumit, kryesuesi nuk procedoi me votimin e kësaj pike.

8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisioni FunkSIONAL që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e komisionit me rekomandime.

Në emër të Komisioni për Arsim Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, deputeti Shpëtim Bulliqi e paraqiti dhe e arsyetoi raportin dhe 13 rekomandime të komisionit lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Pastaj, kryesuesi hapi diskutimin lidhur raportin e lartshënuar.

Për raportin e Komisionit FunkSIONAL për zbatimin e Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës diskutuan deputetët: Luljeta Veselaj-Gutaj, në emër të GP të PDK-së; Shpejtim Bulliqi, në emër të GP të LDK-së; Mufera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe: Mexhide Mjaku-Topalli, Alma Lama, Nait Hasani, Nuredin Ibishi, Gëzim Kelmendi, Melihate Tërmkolli, Armend Zemaj, Salih Morina, Salihe Mustafa, Veton Berisha, Besa Gaxherri, si dhe nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për mungesë të kuorumit, kryesuesi nuk procedoi me votimin e kësaj pike.

9. Shqyrtimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2014

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisioni FunkSIONAL që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e komisionit me rekomandime.

Në emër të Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Muhamet Mustafa e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit me rekomandime lidhur me performansën e ndërmarrjeve publike për vitin 2014.

Pastaj, kryesuesi hapi diskutimin lidhur raportin e lartshënuar.

Për raportin e Komisionit FunkSIONAL për performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2014 diskutuan këta deputetë: Fatmir Rexhepi, Shaip Muja, Armend Zemaj, Gëzim Kelmendi, Ismet Beqiri dhe Blerim Grainca, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për mungesë të kuorumit, kryesuesi nuk procedoi me votimin e kësaj pike.

Kryesuesi, për mungesë të kuorumit, i mbylli punimet e seancës së sotme për të vazhduar nesër, në orën 10:00.

E premte, 29 prill 2016

Vazhdim i seancës plenare, e filluar më 28 prill

10. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Alma Lama, Raif Qelaj, Margarita Kadriu-Ukelli, Lirije Kajtazi, Vjosa Osmani-Sadriu, Emiljija Rexhepi, Bislim Zogaj, Shaip Muja,

Gëzim Kelemendi, Nuredin Ibishi dhe Nezit Çoçaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

11. Koha për pyetje parlamentare

Për këtë seancë ishin parashtruar katër pyetje parlamentare, por në mungesë të ministrave për t'iu përgjigjur ato u shtyn për seancën e radhës.

12. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi nuk pati kuorum për miratimin e procesverbalit të seancës së mëparshme.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Akademinë e Drejtësisë

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Akademinë e Drejtësisë.

Ministri i Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi, në emër të Qeverisë së Kosovës, e paraqiti dhe e arsyetoi nevojën për miratimin e Projektligjit për Akademinë e Drejtësisë.

Fjala e ministrit Hajredin Kuçi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Akademinë e Drejtësisë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Selville Halimi, në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së dhe Danush Ademi, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe deputeti Abdyl Ymeri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në mungesë të kuorumit, kryetari nuk procedoi me votimin e këtij projektligji dhe i mbylli punimet e kësaj seance në orën 13:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*